**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Lidhet me gjuhët dhe shkathhtësitë e komunikimit, shkathhtësitë për jetë, barazinë gjinore dhe tolerancën, njohjen e medias, komunikimi ndërkurrikular përmes Tik-ut.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Situata e të nxënës


Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja shpjegon llojet e veglave të punës. Më pas, mësuesi/ja shpjegon që veglat mund të grupohen: a) veglat e punës; b) veglat e matjes dhe të kontrollit; c) veglat dhe instrumentet për procesin e shënjimit. A keni provuar ndonjëherë të prisni apo të hapni vrima në një material plastik? Sa e vështirë ka qenë? Diskutoni.

### Veprimet në situatë


#### Hapi I – Diskuti

Mësuesi/ja diskuton mësimin me nxënësit, duke ia demonstruar në mënyrë konkrete njohuritë nëpërmjet veglave të punës që ai/ajo ka në klasë, si dhe duke u dhënë informacione se si mund të përdoren mjetet e punës.

Në këtë mësim do të mësoni si të përdorni disa nga mjetet që shërbejnë për përpunimin e materialeve plastike.



Sharrimi i plastikës



Shpimi i vrimave në materialet plastike



Ngjitja e materialeve plastike

#### Hapi II – Rrjeti i diskutimit

Nxënësit i këmbëjnë materialet me njëri-tjetrin dhe diskutojnë cilin prej tyre njohin më shumë. Ku mund të përdoren? Përse na shërbejnë në jetën tonë? Si na e lehtësojnë procesin e punës?

Nxënësit mund të diskutojnë se si përdoren mjetet, cilat janë rregullat e sigurisë në punë dhe kujdesi që duhet treguar ndaj këtyre mjeteve.

Udhëzimet e sigurisë

1. Sigurohuni që gryka të mos ketë mbetje të vjetra të ngjitësit.
2. Gjithmonë sigurohuni që pistoletë ngjitëse të jetë shkëputur nga priza përpara se të pastroni ose hiqni grykën.
3. Asnjëherë mos përdorni ujë për të pastruar një pistoletë ngjitëse.
4. Nëse është e mundur, vishni një palë doreza teksa punoni me ngjitës të nxehtë, për të mbrojtur duart tuaja nga nxehtësia dhe rrëmuja.

#### Hapi III – Provo veten

Nxënësit zgjidhin ushtrimet e dhëna në libër dhe i diskutojnë ato me mësuesin/en.

## VLERËSIMI I NXËNËSVE

Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund t'u përgjigjen pyetjeve konkrete të vendosura në fund të mësimin.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

**Punë e pavarur:** Nxënësit realizojnë në shtëpi detyrën e dhënë në fletoren e punës. Në mësimin tjetër, klasën e ndaj në dy grupe dhe u përcaktoj mjetet e punës që duhet të kenë secili grup për kryerjen e veprimtarisë.

## REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

### ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

|                                                                |                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                   |
|----------------------------------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|
| <b>Fusha kurrikulare:</b><br>Jeta dhe puna dhe<br>dhe shëndeti | <b>Lënda:</b> Teknologji<br>me TIK | <b>Shkalla e kurrikulës:</b><br>III                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | <b>Klasa:</b> VII |
| <b>Tema:</b> Materialet dhe përpunimi i tyre                   |                                    | <b>Rezultati i të nxënit të temës:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Përdor mjete të ndryshme për përpunimin e materialeve.</li> <li>➤ Klasifikon mjetet e dorës për nga funksioni, profesioni dhe materiali.</li> <li>➤ Kryen përpunime në forma të ndryshme të objekteve me materiale artificiale dhe krijon modele të ndryshme prej tyre në kabinet.</li> </ul> |                   |

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.1.1,1.2,1.3; II.2.1; III.3.1,3.2; IV.4.1,4.2; V.5.1; VI.6,1; VIII. 8.1; IX.9,1,9.2.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

- 2.1 Kupton drejt dhe zbaton udhëzimet e shkruara dhe pasqyrimet pamore për aktivitete të ndryshme praktike.
- 4.1 Përdor veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar produkte, modele të thjeshta, bazuar në skica dhe udhëzime.
- 6.1 Zbaton rregullat për mbrojtje dhe siguri, parandalon dhe ndihmon në menaxhimin e rreziqeve në punë.
- Angazhohet për ruajtjen e baraspeshës ekologjike të mjedisit.
- 8.1 Identifikon burime të ndryshme të informimit e të orientimit për arsim, aftësim profesional dhe punësim.

### ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: 1.8** Punime me materiale plastike

**Fjalët kyçe:** mjete dore, mjete mbajtëse, aksesori.

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- Kryen përpunime në forma të ndryshme objekte të ndryshme të objekteve me materiale artificiale dhe krijon modele të ndryshme prej tyre.
- Kriteret e suksesit:
- 1.Krijon objekte të ndryshme me materiale plastike.
  - 2.Aftësohet në kryerjen e punës konkrete të krijimit të mjeteve praktike të thjeshta funksionale.
  - 3.Demonstron punën e kryer në punën në grup.

- Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: pipëza plastike 1 rul kartoni që shërben për mbajtjen e letres së kuzhinës ose tualetit; fletë kartoni e trashë me ngjyrë; gërrshërë, vizore, laps, pistoletë me ngjitës silikoni (nëse nuk keni pistoletë, mund të përdorni vinovil).

[https://www.youtube.com/watch?v=8mU\\_7ccLqxk](https://www.youtube.com/watch?v=8mU_7ccLqxk), <https://www.boredart.com/2019/08/repurposing-plastic-straw-crafts-ideas.html>, <https://www.pinterest.com/pin/17099673561832460/>

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**  
Zhvillimi i njohurive nëpërmjet punës praktike.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Është shumë e rëndësishme që mësuesi/ja të ketë njoftuar më parë nxënësit në lidhje me materialet që duhen për të ndërtuar. Idealja do ishte që grupe të ndryshëm t'i ndërtonin me materiale të ndryshme. Një grup (grup i parë) mund të lihet i lirë për të ndërtuar me materiale të riciklueshme. Në fund të ushtrimit, diskutohet se cili është grupi që ndoqi me më shumë përpikëri hapat, si arritën ata të ndërtonin objekte të ndryshme.


Në këtë punë praktike, nxënësit zhvillojnë njohuritë e mësuara falë zbatimit të tyre në praktikë.

### Hapi I

Pasi janë përcaktuar mjetet e nevojshme për secilin grup

#### Mjetet e nevojshme:

- pipëza plastike që përdoren për pirjen e lëngjeve;
- 1 rul kartoni që shërben për mbajtjen e letrës së kuzhinës ose tualetit;
- 1 fletë kartoni e trashë me ngjyrë;
- gërrshërë;
- vizore;
- laps;
- pistoletë me ngjitës silikoni (nëse nuk keni pistoletë, mund të përdorni vinovil).




#### Hapat që duhet të ndiqni:

Grupi i dytë janë të lirë sugjerohet me tapat e shisheve plastike të ndërtojnë një motiv për këtë mund të jenë njoftuar që me fillimin e këtij kapitulli.

#### Klasa mund të ndahet në 2 grupe.

Grupi 1: Ndërton objektin me mjetet e punës të cilat i kanë të disponueshme në lidhje me punën që do të kryejnë.

Grupi 2: Ndërton objektin me mjetet e punës të cilat i kanë të disponueshme në lidhje me punën që do të kryejnë.



### Hapi II

Në fund të aktivitetit, nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin, dallimin që ka midis dy mekanizmave. Gjithashtu, ata diskutojnë ku mund të përdoren këto mekanizma në jetën e përditshme.

### Hapi III

Secili nga nxënësit shkruan në fletoren e tij/saj, një paragraf të vogël se çfarë mësuan falë kësaj detyre.

## VLERËSIMI I NXËNËSVE

Situata quhet e realizuar kur nxënësit kanë realizuar detyrën e hapit III, si dhe kanë realizuar me sukses detyrën e grupit dhe të kuptojnë rëndësinë e riciklimit.

### DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

**Punë e pavarur:** Nxënësit realizojnë në shtëpi detyrën e dhënë në rubrikën “Provo veten” në tekstin e nxënësit.

[https://www.youtube.com/watch?v=8mU\\_7ccLqxE](https://www.youtube.com/watch?v=8mU_7ccLqxE), <https://www.boredart.com/2019/08/repurposing-plastic-straw-crafts-ideas.html>, <https://www.pinterest.com/pin/17099673561832460/>

Në fletoren e punës do të gjeni projekte të shumëllojshme, të cilat mund t'i realizoni në shtëpi ose në klasë.

### REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                   |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|
| <b>Fusha kurrikulare:</b> Jeta dhe puna dhe dhe shëndeti                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | <b>Lënda:</b> Teknologji me TIK | <b>Shkalla e kurrikulës:</b> III                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | <b>Klasa:</b> VII |
| <b>Tema:</b> Shkathtësitë e të punuarit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                 | <b>Rezultati i të nxënit të temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>➤ kryen përpunime në forma të ndryshme të objekteve me materiale artificiale brenda dhe jashtë klasës;</li><li>➤ krijon modele të ndryshme me materiale plastike në kabinet;</li><li>➤ skicon dhe krijon modelin e çikrikut, modele tjera, sipas kritereve të dhëna në libër ose manual me materiale adekuate.</li></ul> |                   |
| <b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b><br>I.1.1,1.2 II.2.1 III.3.2 IV.4.1 V.5.1 VI.6.1 IX.9.1,9.2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                   |
| <b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b><br>1.1 Zbaton aktivitete individuale dhe në grup në mjedis shkollor dhe në komunitet.<br>1.2 Kryen aktivitete konkrete praktike sipas planifikimit të parashtruar.<br>2.1 Kupton drejt dhe zbaton udhëzimet e shkruara dhe pasqyrimet pamore për aktivitete të ndryshme praktike.<br>3.2 Përdor veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar produkte, modele të thjeshta, bazuar në skica dhe udhëzime.<br>6.1 Zbaton rregullat për mbrojtje dhe siguri, parandalon dhe ndihmon në menaxhimin e rreziqeve në punë. |                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                   |
| ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                   |
| <b>Njësia mësimore: 2.1</b> Ndërtimi i rrotullës çikrikut                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                   |
| <b>Fjalët kyçe:</b> model çikriku, libër, manual, materiale.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                   |
| <b>Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore</b><br>Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>➤ skicon dhe krijon modelin e çikrikut, modele të tjera, sipas kritereve të dhëna në libër ose manual me materiale të përshtatshme.</li></ul> Kriteret e suksesit:<br>1.trego hapat e duhur për të ndërtuar një varëse rrobash metalike;<br>2.ndërto çikrikun – rrotullën e palëvizshme sipas kritereve të dhëna.                                                                                                                                                           |                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                   |
| <b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> teksti shkollor, kompjuteri, mjete audio-vizuale (video-projektori). varëse rrobash metalike; bobinë peri; spango ose pe i hollë; darë ose pinca.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                   |
| <b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b><br>Nxënësit mund të kuptojnë më mirë disa koncepte të lëndës së Fizikës, Shkathtësitë për jetë, Puna vullnetare, Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të përfitimeve që vijnë falë punës si vullnetar/e.                                                                                                                                                                                                          |                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                   |

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

### Veprimet në situatë

#### Situata e të nxënës

Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja shpjegon teorinë duke realizuar objektet në planin e punës dhe tregon mjetet e punës me të cilat do të krijojnë sistemin e çikrikut. Për të fituar kohë, klasa mund të ndahet në grupe dhe secilit grupit t'i kërkohet të zhvillojë veprimtarinë mësimore.

#### Mjetet e punës:

Varëse rrobash metalike

Bobinë peri

Spango ose pe i hollë

Darë ose pinca, duke ndjekur zhvillimin e veprimtarisë sipas hapave deri në realizimin e detyrës.

Grupi i parë: Ndërtimi i rrotullës së palëvizshme, eksperimente, ndërtim tabele me të dhëna funksioni i saj në lidhje me ligjet e fizikës.

Grupi i dytë: Ndërtimi i rrotullës së palëvizshme, eksperimente ,funksioni i saj ndërtimi i grafikut me vlerat e gjetura.

Grupi i tretë: Ndërtimi i rrotullës së palëvizshme, përdorime të rrotullës së palëvizshme në jetën e përditshme.

#### Hapi II

Është shumë e rëndësishme që në çdo grup të ketë një lider që orienton punën e grupit dhe në këtë mënyrë, nxënësit mësojnë edhe disa cilësitë e liderit.

Gjatë organizimit të aktiviteteve do këshillohej që të realizoheshin foto të çdo procesi të zhvillimit të aktivitetit të cilët mund të pasqyrojnë këndin e shkollës apo të klasës.

#### Hapi III

Mësuesi/ja diskuton si u ndien nxënësit gjatë këtij aktiviteti. Cila ishte pjesa më e vështirë si ia dolën që të përfundonin ushtrimin? Nxënësit mësojnë kështu edhe rëndësinë e bashkëpunimit për të zgjidhur probleme.

### VLERËSIMI I NXËNËSVE

Situata quhet e realizuar kur nxënësit kanë mundur të realizojnë veprimtarinë e dhënë dhe zbatimet praktike të çikrikut.

### DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punë e pavarur: Nxënësit realizojnë në shtëpi detyrën e dhënë.

### REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                   |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|
| <b>Fusha kurrikulare:</b><br>Jeta dhe puna dhe<br>dhe shëndeti                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | <b>Lënda:</b><br>Teknologji me TIK | <b>Shkalla e kurrikulës:</b><br>III                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | <b>Klasa:</b> VII |
| <b>Tema:</b> Shkathtësitë e të punuarit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                    | <b>Rezultati i të nxënit të temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- kryen përpunime në forma të ndryshme të objekteve me materiale artificiale brenda dhe jashtë klasës;</li><li>- krijon modele të ndryshme me materiale plastike në kabinet;</li><li>- skicon dhe krijon modelin e çikrikut, modele tjera, sipas kriterëve të dhëna në libër ose manual me materiale adekuate.</li></ul> |                   |
| <b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b><br>I.1.1,1.2 II.2.1 III.3.2 IV.4.1 V.5.1 VI.6.1 IX.9.1,9.2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                   |
| <b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b><br>1.1 Zbaton aktivitete individuale dhe në grup në mjedis shkollor dhe në komunitet.<br>1.2 Kryen aktivitete konkrete praktike sipas planifikimit të parashtruar.<br>2.1 Kupton drejt dhe zbaton udhëzimet e shkruara dhe pasqyrimet pamore për aktivitete të ndryshme praktike.<br>3.2 Përdor veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar produkte, modele të thjeshta, bazuar në skica dhe udhëzime.<br>6.1 Zbaton rregullat për mbrojtje dhe siguri, parandalon dhe ndihmon në menaxhimin e rreziqeve në punë. |                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                   |
| ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                   |
| <b>Njësia mësimore:</b> Ndërtimi i vinçit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                   |
| <b>Fjalët kyçe:</b> vinçi, të dhëna, bazament, leva, rrotulla, spangoja.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                   |
| <b>Nxënësi/ja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>➤ skicon dhe krijon modelin e çikrikut, modele të tjera, sipas kriterëve të dhëna në libër ose manual me materiale të përshtatshme.</li></ul> <b>Kriteret e suksesit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>1.krijo modele sipas kriterëve të makinave të thjeshta;</li><li>2.kupto rëndësinë e mjeteve të thjeshta për të kryer punë dhe funksionin e tyre;</li><li>3.trego hapat e duhur për të kryer veprimtarinë praktike sipas udhëzimeve në punën në grup.</li></ul>                                            |                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                   |
| <b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> teksti shkollor, kompjuteri, mjete audiovizuale. (videoprojektori).                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                   |
| <b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b><br>Nxënësit mund të kuptojnë më mirë disa koncepte të lëndës së Fizikës, Shkathtësie për jetë, Puna vullnetare, Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të përfitimeve që vijnë falë punës si vullnetar/e. Gjithashtu, zhvillon kompetencën e zgjidhjes së problemeve për të punuar në sektorin ku ka aftësitë kryesore.                                                                                             |                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                   |

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

### Veprimet në situatë

#### Situata e të nxënës

Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja ndan klasën në grupe për realizimin e ndërtimit të vinçit. Për të fituar kohën, klasa mund të ndahet në grupe dhe secilit grupit t'i kërkohet të zhvillojë veprimtarinë mësimore.

#### Mjetet e punës:

Secili grup duke ndjekur zhvillimin e veprimtarisë sipas hapave deri në realizimin e detyrës.


Grupi i parë: Ndërtimi i bazamentit (struktura mbajtëse) me mjetet e nevojshme.

Grupi i dytë: Ndërtimi i çikrikut

Grupi i tretë: Montimi i çikrikut në strukturë

Grupi i katërt: Ndërtimi i levës ngritëse


Grupi i pestë: Montimi i sistemeve të rrotullave



### Hapi II

Është shumë e rëndësishme që në çdo grup të ketë një lider që orienton punën dhe në këtë mënyrë, nxënësit mësojnë edhe disa nga cilësitë e liderit.

Realizimi i detyrës



### Hapi III

Mësuesi/ja diskuton si u ndien nxënësit gjatë këtij aktiviteti. Cila ishte pjesa më e vështirë dhe si ia dolën që të përfundonin ushtrimin? Nxënësit mësojnë kështu edhe rëndësinë e bashkëpunimit për të zgjidhur probleme.

## VLERËSIMI I NXËNËSVE

Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund t'u përgjigjen pyetjeve konkrete të vendosura në fund të mësimit.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punë e pavarur: Nxënësit realizojnë në shtëpi detyrën e dhënë në rubrikën Provo veten në tekstin e nxënësit.



## REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                   |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|
| <b>Fusha kurrikulare:</b><br>Jeta dhe puna dhe shëndeti                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | <b>Lënda:</b> Teknologji me TIK | <b>Shkalla e kurrikulës:</b><br>III                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | <b>Klasa:</b> VII |
| <b>Tema:</b> Shkathësitë e të punuarit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                 | <b>Rezultati i të nxënit të temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- kryen përpunime në forma të ndryshme të objekteve me materiale artificiale brenda dhe jashtë klasës;</li><li>- krijojnë modele të ndryshme me materiale plastike në kabinet;</li><li>- skicon dhe krijojnë modelin e çikrikut, modele tjera, sipas kriterëve të dhëna në libër ose manual me materiale adekuate.</li></ul> |                   |
| <b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b><br>I.1.1,1.2 II.2.1 III.3.2 IV.4.1 V.5.1 VI.6.1 IX.9.1,9.2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                   |
| <b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b><br>1.2 Kryen aktivitete konkrete praktike sipas planifikimit të parashtruar.<br>2.1 Kupton drejt dhe zbaton udhëzimet e shkruara dhe pasqyrimet pamore për aktivitete të ndryshme praktike.<br>3.2 Përdor veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar produkte, modele të thjeshta, bazuar në skica dhe udhëzime.<br>9.1 Adreson sfidat e tashmes dhe të ardhmes në mënyrë konstruktive dhe kreative për të krijuar një shoqëri më të qëndrueshme.<br>9.2 Angazhohet për ruajtjen e baraspeshës ekologjike të mjedisit. |                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                   |
| ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                   |
| <b>Njësia mësimore:</b> 2.2 Prodhimi i materialit plastik-polimeret                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                   |
| <b>Fjalët kyçe:</b> krijimtari, polimer, modele, mjete, materiale.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                   |
| <b>Nxënësi/ja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>➤ krijojnë modele të ndryshme duke paraqitur polimeret.</li></ul> Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"><li>1.ka njohuri të përgjithshme rreth polimereve;</li><li>2.tregon hapat e duhur për të krijuar polimere me materiale të thjeshta;</li><li>3.krijojnë polimere me materiale të thjeshta.</li></ul>                                                                                                                                                                                                   |                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                   |
| <b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> teksti shkollor, kompjuteri, mjete audiovizuale (video-projektori).                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                   |
| <b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b><br>Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të përfitimeve që vijnë falë punës si vullnetar/e. Gjithashtu, zhvillon kompetencën e zgjidhjes së problemeve për të punuar në sektorin ku ka aftësitë kryesore.                                                                                                                                                                                                               |                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                   |

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

### Situata e të nxënit

Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja shpjegon çfarë janë polimeret dhe si mund të krijojmë vetë polimere, duke i ilustruar me disa fotografi sqaruese.



### Veprimet në situatë

**Hapi I** – Diskutim Mësuesi/ja diskuton mësimin me nxënësit, duke ua demonstruar në mënyrë konkrete njohuritë nëpërmjet fotografive që mësuesi/ja ka siguruar nga interneti.

Rendit mjetet e punës për krijimin e polimerit; ngjitës i bardhë shkollor, ujë, detergjent pluhur, gotë e vogël, lugë e vogël çaji, lugë për përzierje, letër tualeti. Tregoj hap pas hapi mënyrën e përgatitjes së polimerit.

**Hapi II** – Rrjeti i diskutimit Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin. Si duket polimeri juaj? A kërcen? Mund ta zgjatni? A mund t'i jepni formë? Si mund ta përshkruani polimerin me fjalët tuaja?

